

## RELACION

### PËR

### PROJEKTVENDIMIN

### “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT MË TË HOLLËSISHME TË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLAVE VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE DHE KËSHILLIT KOMBËTAR PËR SIGURINË NË KOMUNITET”

#### I. QËLLIMI I PROJEKT AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka për qëllim miratimin mbi përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KSK).

Nëpërmjet miratimit të projektvendimit “*Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet*”, synohet të arrihen këto objektiva:

1. Evidentimi dhe trajtimi në kohë i problematikave dhe çështjeve të rëndësishme që cënojnë rendin dhe sigurinë në komunitet;
2. Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe me institucionet e ndryshme me rol dhe përgjegjësi për sigurinë në komunitet;
3. Përmirësimi i sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe nëpërmjet proaktivitetit institucional;
4. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të sigurisë ndaj komunitetit nga ana e strukturave përgjegjëse;
5. Adresimi për zgjidhje të problematikave të sigurisë në komunitet, në nivel qendror.

Me miratimin e këtij akti, do të mundësohet krijimi i një baze ligjore të nevojshme për organizimin dhe funksionimin në mënyrë efektive të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet, me qëllim konsolidimin dhe standardizimin e veprimitarisë së këtyre strukturave në nivel vendor dhe qendror.

Në këtë kuadër do të realizohet:

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet*”

---

- ngritja dhe fuqizimi i kapacitetave të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe rrjedhimisht rritja e rolit të tyre në çështjet e sigurisë publike si një nga çështjet më të rëndësishme për komunitetin;
- informimi i pjesëmarrësve të KVSP-ve mbi çështje të sigurisë në komunitet, si dhuna në familje, kriminaliteti, siguria në institacione arsimore parauniversitare, përdorimi i lëndëve narkotike dhe sigurimi i një përgjigje sa më efikase nga ana e institucioneve që ata përfaqësojnë;
- përmirësimi i koordinimit mes KVSP-ve dhe strukturave të tjera lokale, përgjegjëse për menaxhimin e krizave, përfshirë katastrofat natyrore dhe kërcënimet për shëndetin publik (pandemitë), nëpërmjet hartimit të planeve të përbashkëta lokale;
- rritja e pjesëmarrjes dhe aktivizimit qytetar në KVSP, nëpërmjet ndërmarrjes së fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit nga KVSP-të, lidhur me rreziqet e sigurisë në komunitet dhe informimin e publikut mbi rolin e të gjithë aktorëve lokalë institucionalë.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi “*Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet*”, lidhet me realizimin e programit të Këshillit të Ministrave dhe nuk është i parashikuar në Programin Analistik të Projektakteve për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2024.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKT AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Aktualisht evidentohet se çështjet e sigurisë publike trajtohen në rrafshin vertikal, ku aktori i vetëm “de facto” përgjegjës për garantimin e tij është Policia e Shtetit, fakt që ka sjellë një mbingarkesë në zbatimin e detyrimeve nga ana e Policisë së Shtetit. Fuqizimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike është një faktor kyç në rritjen e efikasitetit të institacioneve qendrore dhe vendore në parandalimin dhe trajtimin e kriminalitetit, dhunës, diskriminimit, ngacmimive dhe fenomeneve të tjerë problematike për qytetarët.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet*”

---

## **AKTIT**

Projektvendimi “*Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KKS)*”, është i përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) pikë:

- Në pikën 1 përcaktohet përbërja, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KKS).
- Në pikën 2, përcaktohet se KVSP kryesohet nga Prefekti i Qarkut dhe përbëhet nga:
  - Kryetari i Bashkisë;
  - Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë;
  - Shefi i Komisariatit të Policisë;
  - Drejtuesi i Policisë Bashkiake;
  - Drejtori i Drejtorisë Rajonale Arsimore;
  - Përgjegjësi i Sektorit të Emergjencave Civile në Prefekturë;
  - Drejtori ose shefi i sektorit të MZSH-së në bashki;
  - Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
  - Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor;
  - Drejtori Rajonal i Institutit të Shëndetit Publik;
  - Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit;
  - Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
  - Drejtori i Agjencisë Rajonale të Pyjeve;
  - Koordinatori vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;
  - Përfaqësuesi i njësisë për mbrojtjen e fëmijëve;
  - Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrotjes së Territorit (IMT);
  - Përfaqësuesi i Agjencisë të Mbrotjes së Konsumatorit;
  - Përfaqësuesi i Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut;
  - Përfaqësuesi i shoqatave të njësive të vetëqeverisjes vendore;
  - Përfaqësuesi i shoqatave të mbrojtjes së konsumatorëve;
- Në pikën 3, përcaktohet se Kryetari i KVSP-së gjëzon të drejtën të ftojë përfaqësues të:

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet*”

- Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridksionit të Përgjithshëm;
  - Prokurorisë së Juridksionit të Përgjithshëm;
  - Partive politike me përfaqësim në Këshillin Bashkiak;
  - Komuniteteve fetare;
  - Organizataave joftimprurëse.
- Në pikën 4, përcaktohet se KVSP funksion si një organizëm koordinues, identifikues dhe konsultues mbi problematikat që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet.
- Në pikën 5, përcaktohet se Kryetari i KVSP-së, ushtron përgjegjësitë si më poshtë:
- a) Ndërrmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të KVSP-së;
  - b) Organizon mbledhjet e KVSP-së minimalisht 1 (një) herë në 3 muaj, ose sa herë vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e tij;
  - c) Evidenton përgjegjësitë institucionale për zbatimin e prioriteteve mbi çështjet e sigurisë;
  - ç) Rekomandon te anëtarët e KVSP-së, të ndërmarrin veprime për çështjet e sigurisë publike;
  - d) Miraton raportin mbi diskutimet, rezultatet, rekomandimet dhe vendimet pas çdo takimi të KVSP-së;
  - dh) Paraqet dhe informon për takimin e radhës më të afërt, mbi vendimet apo rekomandimet e KVSP-së;
  - e) Përfaqëson KVSP-në në marrdhëni me të tretët, duke përfshirë dhe bashkëpunimet me organizmat ndërkombëtare;
  - ë) Mbledh në takimet e KVSP-së anëtarët e ftuar.
  - f) Informon pas çdo takimi, Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet.
- Në pikën 6, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike:
- a) Angazhohet për parandalimin, minimizimin e rreziqeve dhe kërcenimeve në çështjet që cënojnë sigurinë në komunitet;
  - b) Analizon dhe vlerëson situatën mbi çështjet e sigurisë në komunitet;
  - c) Identifikon dhe evidenton problematikat lidhur me sigurinë në komunitet dhe i trajton ato në takimet e këshillit;

---

*Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet”*

- ç) Referon për zgjidhje, problematikat e rasteve konkrete përmes kryetarit të KVSP-së tek autoritetet kompetente shtetërore, pjesëmarrëse ose jo në KVSP;
- d) Përcakton prioritetet në fushën e sigurisë në komunitet dhe i përfshin ato për t'i trajtuar në planin vjetor të veprimit të punës, të miratuar në mbledhjen e parë të çdo viti dhe ua njofton ato institucioneve dhe strukturave përgjegjëse;
- dh) Analizon dhe merr në shqyrtim aspekte të caktuara të veprimitarës së institucioneve me përgjegjësi në fushën e sigurisë publike në komunitet dhe i relaton ato tek drejtuesit e tyre;
- e) Shqyrton dhe miraton kërkesat mbi nevojën e financimit të projekteve apo aktiviteteve, të lidhura me sigurinë në komunitet dhe kërkon mundësi për financimin e tyre;
- ë) Analizon dhe shqyrton nivelin e kapaciteteve të strukturave të sigurisë vendore dhe sugjeron rritjen e tyre;
- f) Kontribuon dhe siguron pjesëmarrje në aktivitete ndërgjegjësuese për komunitetin, edhe përmes projekteve mbi çështjet e sigurisë në komunitet;
- g) Merr në shqyrtim përbashken e objektivave dhe realizimin e masave të përfshira në planin vjetor të veprimit;
- gj) Përcakton përbërjen e sekretariatit teknik;

➤ Në pikën 7, përcaktohet funksionimi i Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, si organ kolegjal, i cili kryesohet nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe ka në përbërje përfaqësues në nivel Drejtor i Përgjithshëm të:

- a) Ministrisë së Brendshme;
- b) Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- c) Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- c) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- d) Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- dh) Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- e) Ministrisë së Financave;
- ë) Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- f) Ministrisë së Mbrojtjes;
- g) Ministrisë së Drejtësisë;
- gj) Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet*”

➤ Pika 8, përcakton të drejtën e Kryetarit të KSKS-së, për të ftuar përfaqësues të:

- Prokurorisë së Përgjithshme;
- Komuniteteve fetare;
- Organizatave jo fitimprurëse.

➤ Pika 9 përcakton përgjegjësitë e kryetarit të KSKS-së, si më poshtë:

- a) Thërret dhe drejton mbledhjet e KSKS-së, si rregull 2 (dy) herë në vit;
- b) Miraton rendin e ditës dhe raportin përfundimtar të mbledhjeve;
- c) Cakton sekretariatin teknik të KSKS-së, drejtorinë që mbulon çështjet e rendit dhe sigurisë publike në Ministrinë e Brendshme;
- ç) Informon Ministrin e Brendshëm për veprimtarinë e KSKS-së;
- d) Prezanton raportin vjetor të KSKS-së pranë Ministrit të Brendshëm.

➤ Pika 10 përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e KSKS-së, si vijojnë:

- a) Identifikon përmes raporteve të KVSP-ve, çështjet problematike të sigurisë në komunitet, me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e tyre pranë institucioneve përkatëse shtetërore qendrore;
- b) Relaton nëpërmjet raporteve dhe analizave tek ministri i Brendshëm nevojën përhartimin e politikave të caktuara në fushën e sigurisë publike;
- c) Orienton KVSP-në mbi aplikimin dhe përfshirjen e praktikave më të mira, në trajtimin e çështjeve të sigurisë në komunitet;
- ç) Rekomandon KVSP-së zbatimin në mënyrë të njëjtë të politikave kombëtare në fushën e sigurisë;
- d) Garanton marrëdhënie bashkëpunimi të ndërsjelltë me KVSP-në;

➤ Pika 11 përcakton prefektin e qarkut dhe institucionet e përmendura në pikën 2 dhe pikën 7, për zbatimin e këtij vendimi.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen me zbatimin e projektvendimit prefekti i qarkut dhe institucionet e përmendura në pikën 2 dhe pikën 7.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet”

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është hartuar me kontributin e Ministrisë së Brendshme, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 12/1, të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar.

Fillimisht projektvendimi dhe relaciioni shoqëruar është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-akte dhe në rrugë zyrtare pranë:

- Ministrisë së Financave,
- Ministrisë së Drejtësisë,
- Ministrisë së Mbrojtjes,
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit,
- Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit,
- Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor,
- Këshillit Konsultativ Qeverisje Qendrore – Vetëqeverisje Vendore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE**

Miratimi i këtij projektvendimi nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI**

**TAULANT BALLA**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet*”